



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



Përmbledhja e

# Pulsit Publik XXVI



Pikëpamjet që janë shprehur në këtë dokument janë të të anketuarve dhe nuk i përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP-së apo të USAID-it.

# Përmbajtja

Lista e tabelave	5
Lista e figurave	5
Përmbledhje ekzekutive	6
Treguesit e pulsit publik	8
Drejtimi politik	9
Siguria personale	10
Indeksi i Demokratizimit dhe Indeksi i Besimit Ekonomik	11
Drejtimi ekonomik	14
Problemet kryesore me të cilat po përballlet Kosova aktualisht	15
Rekrutimi i bazuar në merita në sektorin publik dhe privat	17
Perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë	18
Qëndrimet ndaj votimit	20
Drejtësia tranzicionale	25
Metodologjia	27
Peshimi i totaleve të popullatës	27
Llogaritja e indekseve	28

## Lista e tabelave

<b>TABELA 1</b>	Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kryesore ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë .....	8
<b>TABELA 2</b>	Analiza e trendit të komponentëve të ID-së .....	12
<b>TABELA 3</b>	Analiza e trendit të komponentëve të IBE-së.....	13
<b>TABELA 4</b>	Perceptimet për mbizotërimin e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë.....	19

## Lista e figurave

<b>FIGURA 1</b>	Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës .....	9
<b>FIGURA 2</b>	Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike.....	10
<b>FIGURA 3</b>	Perceptimi i të anketuarve për sigurinë .....	11
<b>FIGURA 4</b>	Kënaqshmëria me drejtim ekonomik të Kosovës.....	14
<b>FIGURA 5</b>	Perceptimet për problemet kryesore me të cilat përballet Kosova aktualisht.....	16
<b>FIGURA 6</b>	Perceptimet për rolin e meritokracisë për punësim në sektorin publik .....	17
<b>FIGURA 7</b>	Perceptimet për rolin e meritokracisë në punësim në sektorin publik kundrejt sektorit privat .....	18
<b>FIGURA 8</b>	Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre lidhur me shkallën e korrupsionit në Kosovë .....	20
<b>FIGURA 9</b>	Perceptimi i të anketuarve lidhur me atë se a mund ta ndryshojë vota e tyre situatën në Kosovë.....	21
<b>FIGURA 10</b>	Perceptimi i burrave dhe grave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë.....	22
<b>FIGURA 11</b>	Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë .....	23
<b>FIGURA 12</b>	Gjasat e të anketuarve për të votuar në qoftë se zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti .....	24
<b>FIGURA 13</b>	Opinionin e të anketuarve për mbulimin profesional të trashëgimisë së konfliktit dhe të kaluarës kolektive të Kosovës në media .....	25
<b>FIGURA 14</b>	Perceptimi i të anketuarve se a do t'i ndihmojë Kosovës marrëveshja për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë në rrugën e saj drejt BE-së. ....	26

# Përmbledhje ekzekutive

**P**ërmbledhja e Pulsit Publik publikohet dy herë në vit dhe që më shumë se njëzet vite ka ndihmuar që institucioneve dhe akterëve të Kosovës<sup>1</sup> t'u ofrohen të dhëna të paanshme dhe të besueshme për treguesit kryesorë përkitazi me perceptimin e qytetarëve për çështjet socioekonomike, politike, të sigurisë dhe ato mjedisore. Të dhënat e Përmbledhjes së Pulsit Publik XXVI janë mbledhur nga 17 prilli deri më 7 maj të vitit 2024, duke e pasqyruar opinionin e mbi 1,300 të anketuarve që i mbulojnë të tridhjetë e tetë komunat e Kosovës. Anketa i ka përfshirë si zonat urbane, ashtu edhe ato rurale, duke i përfshirë shqiptarët e Kosovës, serbët e Kosovës dhe pjesëtarët e tjerë të komuniteteve të Kosovës të moshës 18 vjeç e më lart. Të dhënat që janë mbledhur përmes kësaj ankete janë ndarë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike, për të dhënë informata për dallimet e mundshme në perceptimin e qytetarëve për çështje të ndryshme zhvillimore në Kosovë.

Të dhënat e anketës së majit të vitit 2024 tregojnë se mesatarisht 50.1% e qytetarëve janë të kënaqur me punën e institucioneve kryesore qendrore të Kosovës, që tregon një rritje prej 7.7 pikë të përqindjes krahasuar me të dhënat e anketës së nëntorit të vitit 2023 (42.4%). Rezultatet tregojnë një rritje të kënaqshmërisë me punën e Kabinetit Ekzekutiv, Kryeministrit, Kuvendit, Kryetarit të Kuvendit dhe Presidentes. Kënaqshmëria me punën e Kabinetit Ekzekutiv është evidentuar në shkallë prej 53.3%, duke shënuar një rritje prej 11.5 pikë të përqindjes, krahasuar me 41.8% në nëntor të vitit 2023. Kënaqshmëria me punën e Kryeministrit është evidentuar në shkallë prej 58.3%, duke shënuar një rritje prej 9.4 pikë të përqindjes krahasuar me nëntorin e vitit të vitit 2023 (48.9%). Kënaqshmëria me punën e Kuvendit (52.1%) e ka shënuar rritjen më të lartë të shkallës së kënaqshmërisë (rritje prej 13.4 pikë të përqindjes) krahasuar me 38.7% në nëntor të vitit 2023. Kënaqshmëria me punën e Kryetarit të Kuvendit ka shënuar rritje prej 12.2 pikë të përqindjes, ku 64.4% e qytetarëve kanë deklaruar se janë të kënaqur me punën e Kryetarit të Kuvendit në maj të vitit 2024, krahasuar me 52.2% në nëntor të vitit 2023. Kënaqshmëria me Presidenten e ka treguar nivelin më të lartë të kënaqshmërisë me institucionet kryesore qendrore të Kosovës, ku 69% kanë qenë të kënaqur me punën e Presidentes në maj të vitit 2024, krahasuar me 56.2% në nëntor të vitit 2023.

Nga ana tjetër, është evidentuar një rënie e kënaqshmërisë me punën e gjykatave dhe të prokurorisë. Është shënuar një rënie e kënaqshmërisë me punën e gjykatave për 2.2 pikë të përqindjes në maj të vitit 2024 (27.1%) krahasuar me nëntorin e vitit të vitit 2023 (29.3%), ndërsa në maj të vitit 2024 është shënuar një rënie për 3,5 pikë të përqindjes me punën e prokurorisë (26.5%), krahasuar me nëntorin e vitit 2023 (30%).

<sup>1</sup> Për UNDP-në, referencat për Kosovën do të kuptohen se janë në kontekstin e Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit.

Të dhënat e anketës së majit të vitit 2024 tregojnë një rritje të kënaqshmërisë me drejtimin ekonomik aktual (27.5% krahasuar me 20.2% në nëntor të vitit 2023), si dhe me drejtimin politik (36.3% krahasuar me 23.9% në nëntor të vitit 2023).

Indeksi i Demokratizimit (ID-ja) është shënuar me një rritje prej 0,13 pikë të përqindjes (1,62 në maj të vitit 2024, krahasuar me 1,49 në nëntor të vitit 2023). Ngjashëm, Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike (IBE-ja) është shënuar me një rritje prej 0,03 pikë të përqindjes (1,21 në maj të vitit 2024, krahasuar me 1,18 në nëntor të vitit 2023). Si ID-ja, ashtu edhe IBE-ja maten në një shkallë nga 0 pikë (minimumi) deri në 3 pikë (maksimumi), ku vlerat nën 1.5 konsiderohen negative, ndërsa ato mbi 1.5 tregojnë një pikëpamje pozitive për shumicën e njerëzve lidhur me indeksin e demokratizimit dhe atë të besueshmërisë ekonomike.

Në maj të vitit 2024, gjithsej 83.2% përqind e të anketuarve kanë raportuar se ndjehen të sigurt nga dhuna dhe krimi kur janë në rrugë, krahasuar me 79.7% në nëntor të vitit 2023. Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë kanë treguar se 83.4% e burrave dhe 82.9% e grave ndjehen të sigurt kur janë në rrugë.

Ngjashëm me anketën e nëntorit të vitit 2019, tre çështjet kryesore në anketën e majit të vitit 2024 kanë qenë varfëria (16.6%), papunësia (16.3%) dhe çmimet për furnizimet esenciale (12.7%). Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike kanë treguar se tre çështjet kryesore për shqiptarët e Kosovës kanë qenë papunësia (16.8%), varfëria (16.6%) dhe çmimet për furnizimet esenciale (12.8%). Për serbët e Kosovës, varfëria (15.2%), problemet e hapësirës urbane (13.8%) dhe marrëdhëniet ndëretnike (13.3%) kanë qenë tre çështjet kryesore. Tre çështjet kryesore për komunitetet tjera të Kosovës kanë qenë varfëria (19.5%), furnizimi me energji elektrike (14.2%) dhe problemet e hapësirës urbane (11.1%).

Të dhënat e anketës së majit të vitit 2024 kanë treguar një rënie të perceptimit të njerëzve për korrupsionin në shkallë të gjerë në Kosovë. Gjithsej 19.9% e të anketuarve kanë deklaruar se besojnë se korrupsioni në shkallë të gjerë është i përhapur, krahasuar me 25% në maj të vitit 2023.

Gjithsej 52.9% e shqiptarëve të Kosovës, 25.7% e serbëve të Kosovës dhe 51.2% e komuniteteve të tjera të Kosovës besojnë plotësisht ose besojnë se Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë do të ndikojë pozitivisht në jetën e qytetarëve të Kosovës, krahasuar me nëntorin e vitit 2023, kur 59.3% e shqiptarëve të Kosovës, 32.4% e serbëve të Kosovës dhe 62.5% e komuniteteve të tjera të Kosovës kanë besuar në të njëjtën gjë.

Të dhënat shtesë që janë marrë përmes kësaj ankete dhe anketave të mëparshme do të vihen në dispozicion në Platformën e vizualizimit të të Dhënave të Pulsit Publik dhe të dhënave të ASK Data.<sup>2</sup>

<sup>2</sup> Platforma e vizualizimit të të dhënave: <https://bit.ly/4drCAww>

ASKData është platformë e Agjencisë së Statistikave të Kosovës: <https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/>

# Treguesit e pulsit publik

Të dhënat e anketës së Pulsit Publik të majit të vitit 2024 kanë treguar se mesatarisht 50.1% e të anketuarve kanë qenë të kënaqur me punën e institucioneve qendrore kryesore të Kosovës, duke shënuar një rritje prej 7.7 pikë të përqindjes krahasuar me nëntorin e vitit të vitit 2023 (42.4%). Rezultatet kanë treguar një rritje të kënaqshmërisë me punën e Kabinetit Ekzekutiv, Kryeministrit, Kuvendit, Kryetarit të Kuvendit dhe Presidentes. Kënaqshmëria me punën e Kabinetit Ekzekutiv është evidentuar në shkallë prej 53.3%, duke shënuar një rritje prej 11.5 pikë të përqindjes, krahasuar me 41.8% në nëntor të vitit 2023. Kënaqshmëria me punën e kryeministrit është shënuar në shkallë prej 58.3%, duke shënuar një rritje prej 9,4 pikë të përqindjes krahasuar me nëntorin e vitit të vitit 2023 (48.9%). Kënaqshmëria me punën e Kuvendit (52.1%) e ka treguar rritjen më të lartë të kënaqshmërisë, me 13.4 pikë të përqindjes krahasuar me nëntorin e vitit 2023 (38.7%). Kënaqshmëria me punën e Kryetarit të Kuvendit, megjithatë, ka treguar rritje prej 12.2 pikë të përqindjes, ku 64.4% e qytetarëve janë deklaruar të kënaqur me punën e Kryetarit të Kuvendit në maj të vitit 2024, krahasuar me 52.2% në nëntor të vitit 2023. Kënaqshmëria me Presidenten e ka treguar nivelin më të lartë të kënaqshmërisë në institucionet kryesore qendrore të Kosovës, ku 69% kanë qenë të kënaqur me punën e Presidentes në maj të vitit 2024, krahasuar me 56.2% në nëntor të vitit 2023.

**TABELA 1: KËNAQSHMËRIA E TË ANKETUARVE ME INSTITUCIONET KRYESORE EKZEKUTIVE, LEGJISLATIVE DHE GJYQËSORE NË KOSOVË**


Indikatorët politikë	Maj-19	Nën-19	Prill-20	Dhje-20	Maj-21	Nën-21	Prill-22	Nov-22	Prill-23	Nën-23	Maj-24	Trend	
Kënaqshmëria me kabinetin ekzekutiv	Kabineti ekzekutiv	17.70%	14.40%	60.70%	21.30%	59.10%	47.60%	47.20%	41.00%	45.80%	41.80%	53.30%	
	Kryeministri	36.50%	20.70%	65.40%	23.00%	59.50%	53.20%	52.60%	44.90%	51.50%	48.90%	58.30%	
Kënaqshmëria me legjislativin	Kuvendi	19.60%	18.60%	33.40%	22.60%	52.90%	50.30%	50.20%	39.10%	46.40%	38.70%	52.10%	
	Kryetari i Kuvendit	23.60%	20.50%	72.40%	46.70%	59.20%	55.40%	54.40%	50.80%	58.30%	52.20%	64.40%	
Kënaqshmëria me Presidenten	Presidentja	20.40%	21.20%	18.70%	33.90%	63.70%	55.20%	58.40%	56.80%	60.30%	56.20%	69.00%	
Kënaqshmëria me gjyqësorin	Gjykata	18.70%	13.60%	24.80%	23.00%	34.60%	33.90%	39.10%	24.40%	29.00%	29.30%	27.10%	
	Prokuroria	16.40%	14.20%	22.30%	23.00%	30.80%	34.00%	37.10%	22.00%	29.00%	30.00%	26.50%	



## Drejtimi politik

**A**nketa e majit të vitit 2024 ka treguar se një përqindje më e madhe e të anketuarve (36.33%) kanë qenë shumë të kënaqur ose të kënaqur me drejtimin politik drejt të cilit po shkon Kosova aktualisht, krahasuar me 23.9% në nëntor të vitit 2023. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike kanë treguar se 60% e komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 35.9% e shqiptarëve të Kosovës janë shprehur të kënaqur, duke e pasqyruar një rritje nga nëntori i vitit 2023 (25.2% dhe 25.2%, respektivisht). Në anën tjetër, kënaqshmëria e serbëve të Kosovës ka rënë në 5.7% nga 10.4% gjatë të njëjtës periudhë.

**FIGURA1:** KËNAQSHMËRIA E TË ANKETUARVE ME DREJTIMIN POLITIK TË KOSOVËS




Një përqindje pak më e lartë e të anketuarve (33.9%) kanë deklaruar se janë të gatshëm të protestojnë për arsye politike, krahasuar me nëntorin e vitit 2023 (29.8%).

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë kanë treguar se më shumë burra (41.3%) sesa gra (26.6%) janë të gatshëm të protestojnë për arsye politike.

Të dhënat e zbërthyer etnikisht kanë treguar një rënie të gatishmërisë për të protestuar në mesin e serbëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera të Kosovës. Gjithsej 28.6% e serbëve

të Kosovës (30.5% në nëntor të vitit 2023) dhe 18.4% e komuniteteve të tjera të Kosovës (23% në nëntor të vitit 2023) kanë qenë të gatshëm të protestojnë për arsye politike. Megjithatë, në mesin e shqiptarëve të Kosovës është shënuar një rritje e gatishmërisë për të protestuar krahasuar me nëntorin e vitit 2023. Gjithsej 34.3% e shqiptarëve të Kosovës kanë qenë të gatshëm për të protestuar për arsye politike, krahasuar me 28.9% në nëntor të vitit 2023.


**FIGURA 2: PËRQINDJA E TË ANKETUARVE QË DO T'U BASHKOHESHIN PROTESTAVE POLITIKE**



## Siguria personale

**T**ë anketuarit janë pyetur për perceptimin e tyre për nivelin e sigurisë nga dhuna dhe krimi kur janë jashtë në rrugë. Të dhënat e anketës së majit të vitit 2024 kanë treguar një rritje të perceptimit të njerëzve për nivelin e tyre të sigurisë, ku 83.2% kanë deklaruar se ndjehen shumë të sigurt ose deri diku të sigurt kur janë jashtë në rrugë, krahasuar me 79.73% në nëntor të vitit 2023. Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë kanë treguar se një numër pak më i madh i burrave sesa i grave ndjehen të sigurt kur janë jashtë në rrugë, përkatësisht 83.4% dhe 82.9%. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike kanë treguar se një numër më i madh i shqiptarëve të Kosovës (85.3%) dhe komuniteteve të tjera të Kosovës (83.2%) krahasuar me serbët e Kosovës (31.9%) ndjehen të sigurt kur janë jashtë në rrugë. Krahasuar me të dhënat e nëntorit të vitit 2023, të dhënat kanë treguar rritje të perceptimit për sigurinë prej 4.5 pikë të përqindjes tek shqiptarët e Kosovës dhe rritje prej 3.2 pikë të përqindjes tek komunitetet e tjera të Kosovës, me ç'rast këto shifra janë evidentuar si 80.8% dhe 80.0% përkatësisht. Është shënuar një rënie e perceptimit të serbëve të Kosovës për sigurinë në shkallë prej 5.7 pikë të përqindjes krahasuar me nëntorin e vitit 2023, kur kjo shifër ka qenë 37.6%.

FIGURA 3: PERCEPTIMI I TË ANKETUARVE PËR SIGURINË



## Indeksi i Demokratizimit dhe Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike

Në anketën e majit të vitit 2024 është evidentuar një rritje si në ID, ashtu edhe në IBE. Më konkretisht, ID-ja aktuale është rritur për 0.13 pikë (1.62), krahasuar me nëntorin e vitit të vitit 2023, kur ky numër është evidentuar si 1.49. Në anën tjetër, IBE-ja aktuale është rritur për 0,03 pikë (1.21) krahasuar me 1.18 në nëntor të vitit 2023.<sup>3</sup>

Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë kanë treguar se burrat kanë pasur vlerësim më të lartë për ID-në (1.65 pikë) krahasuar me gratë (1.59 pikë) dhe se burrat kanë pasur vlerësim më të lartë edhe për IBE-në (1.26) krahasuar me gratë (1.18).

Gjetjet kanë treguar se të gjithë komponentët e ID-së, përveç njërit, që është paraqitur në tabelën 2, kanë pasur një rritje krahasuar me nëntorin e vitit 2023. Gjithsej 67.4% e të anketuarve kanë pohuar se zgjedhjet në Kosovë janë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, krahasuar me 57.29% në nëntor të vitit 2023. Numri i të anketuarve që kanë besuar se Kuvendi e monitoron

<sup>3</sup> Si ID-ja, ashtu edhe IBE-ja përbëhen nga disa komponentë, të cilët përdoren për t'i gjeneruar indekset përkatëse. ID-ja përbëhet nga nëntë komponentët e paraqitur në tabelën 2 më poshtë. Përgjigjet në pyetjet e këtij indeksi mund të jepen me "Po, plotësisht", "Po, kryesisht", "Jo edhe aq shumë" ose "Aspak". Tabela 2 e tregon përqindjen e të anketuarve që nëntë pyetjeve u janë përgjigjur me "Po, plotësisht" ose "Po, kryesisht". Për të përcaktuar se cilët tregues kanë ndikuar në rënien e ID-së, të dhënat nga anketa e majit të vitit 2024 janë krahasuar me ato që janë gjeneruar në anketat e mëparshme.

punën e Kabinetit Ekzekutiv ka qenë 59.3% në maj të vitit 2024, krahasuar me 44.01% në nëntor të vitit 2023. Gjithsej 34.28% e të anketuarve kanë besuar se Sistemi Gjyqësor në Kosovë është i pavarur në vendimet e tij në maj të vitit 2024, krahasuar me 32.50% në nëntor të vitit 2023. Gjetjet kanë treguar një rritje në besimin se mediat në Kosovë e gëzojnë lirinë e shprehjes, ku 69.69% e të anketuarve besojnë se mediat në Kosovë e gëzojnë lirinë e shprehjes, krahasuar me 61.81% në nëntor të vitit 2023. Gjithsej 51.55% kanë treguar se Shoqëria Civile në Kosovë shërben si monitorues i vërtetë i zhvillimeve demokratike në Kosovë, krahasuar me 46.84% në nëntor të vitit 2023. Rritje është evidentuar edhe në perceptimin e qytetarëve se institucionet vendore punojnë sipas prioriteteve të qytetarëve (50.19% në maj të vitit 2024, krahasuar me 49.40% në nëntor të vitit 2023). Është shënuar rënie në perceptimin se Kabineti Ekzekutiv Qendror punon sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës (50.19% në maj të vitit 2024, krahasuar me 52.7% në nëntor të vitit 2023). Gjithsej 60.71% kanë treguar se Kushtetuta e Kosovës si dhe ligjet në fuqi janë demokratike dhe i respektojnë të drejtat e njeriut, krahasuar me 56.4% në nëntor të vitit 2023. Përfundimisht, 53.45% janë shprehur se proceset demokratike në Kosovë janë institucionalizuar dhe po shkojnë në drejtimin e duhur, krahasuar me 49.22% në nëntor të vitit 2023.

**TABLE 2:** TREND ANALYSIS OF DI COMPONENTS

Po kryesisht dhe po plotësisht	Maj-19	Nën-19	Prill-20	Dhje-20	Maj-21	Nën-21	Prill-22	Nov-22	Prill-23	Nën-23	Maj-24	Trendi
A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare?	35.60%	62.73%	66.30%	45.87%	70.44%	70.88%	73.42%	69.02%	62.20%	57.29%	67.44%	
A e monitoron Kuvendi punën e Kabinetit Ekzekutiv?	38.10%	38.61%	58.00%	45.56%	60.13%	62.95%	67.47%	61.00%	51.30%	44.01%	59.30%	
A është sistemi gjyqësor në Kosovë i pavarur në vendimet e tij?	21.50%	31.48%	39.70%	36.66%	37.50%	44.88%	41.67%	34.49%	29.20%	32.50%	34.28%	
A e gëzojnë mediat në Kosovë lirinë e shprehjes?	45.60%	46.66%	69.10%	57.94%	69.24%	60.70%	69.60%	62.02%	63.70%	61.81%	69.69%	
A shërben shoqëria civile në Kosovë si monitorues i vërtetë i zhvillimeve demokratike në Kosovë?	32.60%	34.79%	50.70%	45.77%	56.56%	55.62%	61.89%	49.83%	51.30%	46.84%	51.55%	
A funksionojnë institucionet tuaja lokale (komunale) sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	29.80%	29.62%	56.70%	41.53%	52.64%	54.88%	55.82%	51.38%	46.70%	49.40%	54.85%	
A punon Kabineti Ekzekutiv Qendror i Kosovës sipas prioriteteve të popullit të Kosovës?	18.10%	24.23%	54.90%	30.61%	54.39%	49.28%	56.78%	44.51%	40.60%	52.70%	50.19%	
A janë kushtetuta e Kosovës si dhe ligjet në fuqi demokratike dhe a i respektojnë ato të drejtat e njeriut?	33.40%	40.30%	64.00%	42.82%	58.07%	59.49%	63.05%	59.07%	60.30%	56.40%	60.71%	
Pavarësisht politikës ditore dhe duke shikuar kah e ardhmja, a pajtoheni që proceset demokratike në Kosovë janë të vendosura dhe po shkojnë në drejtimin e duhur?	22.40%	33.01%	42.50%	36.22%	58.65%	55.65%	59.63%	51.00%	47.50%	49.20%	53.46%	

Për të përcaktuar se cilët tregues kanë ndikuar në rënien e IBE-së, përgjigjet aktuale të komponentëve të IBE-së janë krahasuar me ato që janë mbledhur në anketat e mëparshme, siç është treguar në Tabelën 3 më poshtë. Përgjigjet që ka qenë e mundur të jepeshin në pyetjet që kanë pasur të bëjnë me IBE-në kanë qenë: "të favorshme", "të pafavorshme" dhe "neutrale".

**TABLE 3:** ANALIZA E TRENDIT TË KOMPONENTËVE TË IBE-së

Trendi	Maj-19	Nën-19	Prill-20	Dhje-20	Maj-21	Nën-21	Prill-22	Nov-22	Prill-23	Nën-23	Maj-24	Trendi
Çfarë janë pritshmëritë tuaja për sa u përket gjithsej të ardhurave të familjes suaj pas gjashtë muajve?	11.60%	13.70%	14.20%	11.50%	15.90%	15.90%	17.20%	11.20%	14.30%	15.60%	20.20%	
Çfarë është vlerësimi juaj për kushtet aktuale të biznesit?	5.50%	9.10%	8.20%	7.20%	4.70%	12.80%	7.30%	8.20%	8.40%	11.50%	13.30%	
Çfarë është vlerësimi juaj për kushtet aktuale të punësimit?	5.80%	7.40%	6.60%	5.60%	7.00%	10.80%	6.30%	7.10%	8.20%	16.20%	12.00%	
Çfarë janë pritshmëritë tuaja për sa u përket kushteve të punësimit pas gjashtë muajve?	4.60%	12.00%	11.60%	8.30%	18.80%	15.90%	10.50%	8.30%	12.60%	16.20%	15.80%	

Gjithsej 20,20% kanë pasur pritshmëri të favorshme përkitazi me gjithsej të ardhurat e familjes së tyre gjashtë muaj pas anketës, duke shënuar një rritje prej 4.4 pikë të përqindjes krahasuar me nëntorin e vitit 2023. Gjithsej 13.3% kanë pasur pritshmëri të favorshme për kushtet aktuale të biznesit, duke shënuar një rritje prej 1.8 pikë të përqindjes krahasuar me nëntorin e vitit 2023, kur ky numër ka qenë 11.5%. Një rënie e perceptimit është evidentuar përkitazi me pyetjen se a janë kushtet aktuale të punësimit të favorshme apo jo si dhe me perceptimin për kushtet e punësimit gjashtë muaj pas anketës. Përderisa e para është evidentuar në shkallë prej 12% në maj të vitit 2024, krahasuar me 16.2% në nëntor të vitit 2023, e dyta është evidentuar në shkallë prej 15.8% në maj të vitit 2024, krahasuar me 16.2% në nëntor të vitit 2023.

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë kanë treguar se 22.2% burra dhe 19.1% gra kanë pritshmëri të favorshme për gjithsej të ardhurat e familjes së tyre pas gjashtë muajve. Të dhënat e anketës së majit të vitit 2024 kanë treguar se më shumë burra (16.9%) sesa gra (9.7%) i kanë vlerësuar kushtet aktuale të biznesit si të favorshme dhe se, po ashtu, më shumë burra (14.4%) sesa gra (9.8%) i kanë vlerësuar kushtet aktuale të punësimit si të favorshme. Gjithsej 18.6% e burrave kanë pasur pikëpamje të favorshme për kushtet e punësimit pas gjashtë muajve nga tani, krahasuar me 13.1% gra.


Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike kanë treguar se përderisa 20.3% e shqiptarëve të Kosovës kanë pritshmëri të favorshme përkitazi me gjithsej të ardhurat e familjes së tyre

gjashtë muaj pas kohës kur është bërë anketimi, vetëm 6.1% e komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 5% e serbëve të Kosovës e kanë deklaruar të njëjtën gjë. Një numër më i madh i shqiptarëve të Kosovës (13%) kanë vlerësuar se kushtet aktuale të biznesit janë të favorshme në krahasim me komunitetet e tjera të Kosovës (7.2%) dhe serbët e Kosovës (2.8%). Gjithsej 11.7% e shqiptarëve të Kosovës, 9.4% e serbëve të Kosovës dhe 6.3% e komuniteteve të tjera të Kosovës i kanë vlerësuar kushtet aktuale të punësimit si të favorshme. Përderisa 15.7% e shqiptarëve të Kosovës kanë pasur pritshmëri të favorshme lidhur me kushtet e punësimit, gjithsej 7.9% e komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 5.7% e serbëve të Kosovës kanë pasur mendim të njëjtë.

## Drejtimi ekonomik

Një rritje pozitive e perceptimit për drejtimin ekonomik është shënuar në anketën e majit të vitit 2024, ku 27.3% janë deklaruar shumë të kënaqur ose të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, krahasuar me 20.20% në maj të vitit 2023. Gjithsej 35.9% e të anketuarve kanë qenë neutral krahasuar me 32.1% në nëntor të vitit 2023, dhe 36.8% kanë qenë shumë të pakënaqur ose të pakënaqur krahasuar me 47.70% në nëntor të vitit 2023.

**FIGURA 4: KËNAQSHMËRIA ME DREJTIM EKONOMIK TË KOSOVËS**




Një numër më i madh i burrave (31.2%) krahasuar me gratë (23.4%) kanë qenë shumë të kënaqur apo të kënaqur me drejtimin ekonomik drejt së cilit po shkon Kosova. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike kanë treguar se 44.2% e komuniteteve tjera të Kosovës janë shumë të kënaqur ose të kënaqur me drejtimin ekonomik, krahasuar me 26.8% të shqiptarëve të Kosovës dhe 11% të serbëve të Kosovës. Të dhënat e majit të vitit 2024 tregojnë rritje të kënaqshmërisë me drejtimin ekonomik tek të gjitha etnitë, krahasuar me nëntorin e vitit 2023, kur 28.8% e komuniteteve të tjera të Kosovës kanë qenë të kënaqur me drejtimin ekonomik, të pasuar nga 19.5% të shqiptarëve të Kosovës dhe 7.6% të serbëve të Kosovës.

## Problemet kryesore me të cilat po përballet Kosova aktualisht

**A**shtu si në anketat e mëparshme, të anketuarit janë pyetur për problemet më urgjente me të cilat po përballet Kosova aktualisht. Të dhënat e anketës së majit të vitit 2024 kanë treguar se varfëria (16.6%), papunësia (16.3%) dhe çmimet për furnizimet esenciale (12.7%) janë identifikuar si tre problemet kryesore me të cilat po përballet Kosova. Shërbimet e kujdesit shëndetësor (7.8%) dhe mjedisi (5.6%) kanë qenë ndër pesë problemet kryesore. Përqindja e të anketuarve që e kanë vlerësuar varfërinë si problem madhor ka rënë për 12 pikë të përqindjes, krahasuar me anketën e nëntorit të vitit 2023, kur varfëria (28.6%) është vlerësuar si problem madhor. Në vend të kësaj, përqindja e të anketuarve që e kanë parë papunësinë si problemin madhor kryesor është ulur për 2.9 pikë të përqindjes krahasuar me nëntorin e vitit 2023 (19.2%). Përqindja e të anketuarve që i kanë parë çmimet për furnizimet esenciale si problem madhor është rritur me 3.8 pikë të përqindjes (12.7% në maj të vitit 2024, krahasuar me 8.9% në nëntor të vitit 2023).

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë kanë treguar se gratë e kanë renditur papunësinë si çështjen më madhore kryesore (18%) dhe varfërinë (17.8%) si çështje madhore të dytë, krahasuar me burrat, të cilët varfërinë (15.3%) e kanë renditur si çështjen më madhore, ndërsa papunësinë (14.7%) si çështje madhore të dytë.

Të dhënat e zbërthyer etnikisht kanë treguar se papunësia renditet si problemi madhor kryesor për 16.8% të shqiptarëve të Kosovës, ndërsa varfëria renditet si problemi madhor kryesor për 15.2% të serbëve të Kosovës dhe 19.5% të komuniteteve të tjera të Kosovës. Përderisa varfëria renditet si problemi i dytë më urgjent për 16.6% të shqiptarëve të Kosovës, problemet e hapësirës urbane renditen si problemi madhor i dytë për 13.8% të serbëve të Kosovës, ndërsa energjia renditet si problemi madhor i dytë për 14.2% të komuniteteve të tjera të Kosovës.


**FIGURA 5:** PERCEPTIMET PËR PROBLEMET KRYESORE ME TË CILAT PËRBALLET KOSOVA  
AKTUALISHT



# Rekrutimi i bazuar në merita në sektorin publik dhe privat

Një rritje në perceptimin për punësimin e bazuar në merita është shënuar në maj të vitit 2024, ku 32% e të anketuarve kanë deklaruar se punësimi në sektorin publik është i bazuar në merita, krahasuar me 28% në nëntor të vitit 2023. Kur janë pyetur se çfarë është më e rëndësishmja për punësimin në sektorin publik, ngjashëm me anketat e mëparshme, lidhja familjare (27.3%) dhe besnikëria partiake (24.8%) kanë qenë dy përgjigjet kryesore, të pasuara nga shkollimi (17.9%), përvoja profesionale (9.9%), ryshfeti (8.6%), miqtë (5.7%), aftësimi profesional (4.3%) dhe pamja e jashtme (1.6%).


**FIGURA 6:** PERCEPTIMET PËR ROLIN E MERITOKRACISE PËR PUNËSIM NË SEKTORIN PUBLIK



Ndryshe nga perceptimi për punësimin në sektorin publik, një pjesë më e madhe e të anketuarve (60.8%) besojnë se punësimi në sektorin privat fitohet në bazë të meritës. Ngjashëm me anketat e mëparshme, përvoja profesionale (37%) është perceptuar si kriteri kryesor për punësim në sektorin privat. Në mesin e kriterëve të bazuara në merita, shkollimi ka qenë në shkallë prej 14%, ndërsa aftësimi profesional në shkallë prej 9.7%. Janë identifikuar faktorët jo meritore në vijim për punësim në sektorin privat: lidhja familjare (18.3%), miqtë (14.2%), ryshfeti (3.3%) dhe pamja e jashtme (1%).

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë kanë treguar se kur bëhet fjalë për punësimin në sektorin publik, më shumë burra (34.2%) sesa gra (29.2%) besojnë se punësimi fitohet në bazë të meritës. Kur bëhet fjalë për punësimin në sektorin privat, të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë kanë treguar se, ngjashëm me anketat e mëparshme, burrat (65.5%) kanë qenë më të sigurt në punësimin e bazuar në merita në sektorin privat, krahasuar me gratë (54.9%). Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike kanë treguar se 61% e shqiptarëve të Kosovës dhe 55.8% e komuniteteve të tjera të Kosovës janë më të sigurt në punësimin e bazuar në merita në sektorin privat, krahasuar me 35.2% të serbëve të Kosovës.

**FIGURA 7:** PERCEPTIMET PËR ROLIN E MERITOKRACISË NË PUNËSIM NË SEKTORIN PUBLIK KUNDREJT SEKTORIT PRIVAT



## Perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë

Mesatarisht, 19.9% e të anketuarve kanë perceptuar se korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, duke shënuar një rënie prej 5.15 pikë të përqindjes krahasuar me nëntorin e vitit 2023, kur ky numër ka qenë 25%.

Policia e Kosovës (12.40%) është perceptuar si institucioni më pak i korruptuar, e pasuar nga organizatat ndërkombëtare (13.70%), arsimi (13.8%) dhe komunat (15.9%). Institucionet më të korruptuara janë perceptuar se janë gjykatat (36.5%), Dogana (35.3%) dhe KEDS-i (22.4%).

Ndryshimet pozitive më të mëdha në perceptimin për korrupsionin në shkallë të gjerë janë vërejtur në institucionet në vijim: Administrata Tatimore e Kosovës (17.1% në maj të vitit 2024, krahasuar me 26.4% në nëntor të vitit 2023), Agjencia Kosovare e Privatizimit (22.3% në maj të vitit 2024, krahasuar me 30.7% në nëntor të vitit 2024) dhe Administrata Qendrore (17% në maj të vitit 2024, krahasuar me 24.9% në nëntor të vitit 2023). Rritja e vetme e perceptimit për korrupsionin në shkallë të gjerë është vërejtur tek Gjykatat (36.5% në maj të vitit 2024 krahasuar me 28.80% në nëntor të vitit 2023).


**TABLA 4:** PERCEPTIMET PËR MBIZOTËRIMIN E KORRUPSIONIT NË SHKALLË TË GJERË NË INSTITUCIONET PUBLIKE DHE NDËRKOMBËTARE NË KOSOVË

	Maj-19	Nën-19	Prill-20	Dhje-20	Maj-21	Nën-21	Prill-22	Nov-22	Prill-23	Nën-23	Maj-24	Trendi
Kujdesi shëndetësor (spitalet dhe qendrat e kujdesit shëndetësor familjar)	25.10%	33.40%	11%	25%	22.90%	18.80%	18.10%	18.60%	20.50%	24.60%	18.60%	
KEDS-i	40.70%	38.90%	27.30%	28.70%	26.10%	25.80%	26.50%	24.50%	28.40%	25.60%	22.40%	
KEK-u				27.50%	25.30%	25.80%	26.70%	23.00%	26.10%	25.60%	17.90%	
Gjykatat	30.70%	42.00%	24.50%	31.60%	32.50%	27.70%	27.90%	30.80%	37.70%	28.80%	36.50%	
Dogana	29.30%	41.40%	30.60%	39.20%	34.30%	32.30%	36.20%	26.90%	35.80%	39.00%	35.30%	
Administrata qendrore	36.70%	35.30%	20.80%	29.50%	23.10%	19.50%	13.90%	20.10%	25.30%	24.90%	17.00%	
AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit)	40.70%	48.10%	36.60%	39.00%	39.30%	29.40%	32.60%	28.80%	33.70%	30.70%	22.30%	
Komunat (pushteti lokal)	25.80%	29.80%	13.30%	24.70%	20.40%	19.10%	16.30%	18.40%	15.80%	21.70%	15.90%	
Arsimi (shkolla, universiteti)	20.70%	26.10%	13.60%	19.50%	15.10%	16.80%	12.10%	14.30%	16.90%	17.20%	13.80%	
ATK-ja (Administrata Tatimore e Kosovës)	35.30%	42.20%	18.90%	30.20%	27.40%	28.80%	25.40%	24.10%	21.20%	26.40%	17.10%	
PTK-ja	44.20%	40.80%	37.90%	33.20%	31.60%	23.70%	25.90%	25.30%	25.40%	23.50%	17.30%	
Bankat	33.80%	34.10%	18.90%	28.10%	22.90%	22.20%	20.50%	14.70%	20.70%	24.80%	18.00%	
Organizatrat ndërkombëtare	19.50%	23.60%	5.50%	23.80%	15.70%	17.60%	14.00%	12.20%	14.10%	19.60%	13.70%	
Policia e Kosovës (PK)	17.00%	20.70%	9.80%	15.30%	14.00%	20.50%	14.00%	13.50%	7.30%	17.90%	12.40%	

Ashtu si në anketat e mëparshme, për të kuptuar se çfarë e ka formësuar perceptimin e të anketuarve për korrupsionin në shkallë të gjerë, ata janë pyetur për arsyet e vlerësimit lidhur me praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë. Rezultatet kanë treguar se, sikur në anketat e mëparshme, për 65.3% të të

anketuarve (63.7% në nëntor të vitit 2023), informatat që janë marrë përmes mediave janë ato që i kanë dhënë trajtë perceptimit të tyre për korrupsionin në shkallë të gjerë. Gjithsej 26.8% e të anketuarve kanë pohuar se bisedat me të afërmit kanë qenë ato që e kanë formësuar perceptimin e tyre, ndërsa 6.3% e të anketuarve kanë pohuar se perceptimin e tyre e kanë formësuar përvojat personale (krahasuar me 30.5% dhe 5.5 në nëntor të vitit 2023, respektivisht).


**FIGURA 8:** ARSYET E TË ANKETUARVE PËR VLERËSIMIN E TYRE LIDHUR ME SHKALLËN E KORRUPSIONIT NË KOSOVË




## Qëndrimet ndaj votimit

Në anketën e majit të vitit 2024, gjithsej 39.4% kanë besuar se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, duke shënuar një rritje prej 6.6 pikë të përqindjes krahasuar me nëntorin e vitit 2023, kur ky numër ka qenë 32.8%. Përdërisa 25.6% kanë konsideruar se vota e tyre nuk mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, 33.3% kanë konsideruar se vota e tyre e ndryshon situatën deri diku, ndërsa 1.7% kanë deklaruar se nuk e dinë nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë (krahasuar me 36.3%, 27.9% dhe 3%, respektivisht).


**FIGURA 9:** PERCEPTIMI I TË ANKETUARVE LIDHUR ME ATË SE A MUND TA NDRYSHOJË VOTA E TYRE SITUATËN NË KOSOVË



Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë kanë treguar se më shumë burra (43.4%) sesa gra (35.4%) besojnë se vota e tyre mund të ndikojë në ndryshim, duke shënuar një rritje si te burrat, ashtu edhe te gratë krahasuar me nëntorin e vitit 2023, kur këto shifra kanë qenë 36.3% dhe 29.2% respektivisht. Gjithsej 25.2% e burrave dhe 26% e grave kanë deklaruar se nuk besojnë se vota e tyre mund të çojë në ndonjë ndryshim, ndërsa 29.8% e burrave dhe 36.8% e grave mendojnë se vota e tyre mund të çojë në ndryshim vetëm deri në një masë të caktuar.


**FIGURA 10:** PERCEPTIMI I BURRAVE DHE GRAVE NËSE VOTA E TYRE MUND TA NDRYSHOJË SITUATËN NË KOSOVË

Të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike kanë treguar një rritje në mesin e shqiptarëve të Kosovës për sa i përket besimit të tyre në zgjedhje si mekanizëm për ndryshim, ndërsa një rënie në mesin e serbëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera të Kosovës. Gjithsej 41.3% e shqiptarëve të Kosovës (35.5% në nëntor të vitit 2023), 20% komuniteteve të tjera të Kosovës (30.5% në nëntor të vitit 2023) dhe 5.2% e e serbëve të Kosovës (7.6% në nëntor të vitit 2023) besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshim. Gjithsej 24.7% e shqiptarëve të Kosovës, 44.8% e serbëve të Kosovës dhe 34.2% e komuniteteve të tjera të Kosovës kanë deklaruar se nuk besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshim.

**FIGURA 11:** PERCEPTIMI I KOMUNITETEVE TË NDRYSHME NËSE VOTA E TYRE MUND TA NDRYSHOJË SITUATËN NË KOSOVË

Të anketuarit janë pyetur për gjasat për të votuar nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti. Të dhënat kanë treguar se 75.90% e të anketuarve do të votonin nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti, në krahasim me 72.8% në nëntor të vitit 2023. Gjithsej 9.2% e të anketuarve kanë thënë se nuk do të votonin në qoftë se zgjedhjet do të mbaheshin së shpejti, krahasuar me 14.6% në nëntor të vitit 2023.

**FIGURA 12:** GJASAT E TË ANKETUARVE PËR TË VOTUAR NË QOFTË SE ZGJEDHJET QENDRORE DO TË MBAHESHIN SË SHPEJTI



Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë kanë treguar se gratë (78%) kanë më shumë gjasa që të votojnë nëse zgjedhjet mbahen së shpejti, në krahasim me burrat (74%). Gjithsej 8.2% e burrave dhe 10.2% e grave kanë deklaruar se do të votonin nëse zgjedhjet do të mbaheshin së shpejti.


Të dhënat e zbërthyera etnikisht kanë treguar se gjithsej 81% e komuniteteve të tjera të Kosovës (76.5% në nëntor të vitit 2023), 76% e shqiptarëve të Kosovës (73.9% në nëntor të vitit 2023) dhe 54% e serbëve të Kosovës (64.78%) kanë gjasa të votojnë nëse zgjedhjet do të mbaheshin së shpejti.



## Drejtësia tranzicionale

**P**ulsi Publik e ka trajtuar drejtësinë tranzicionale në Pulset Publike XXIV, XXV dhe XXVI dhe i ka pyetur të anketuarit për perceptimin e tyre në lidhje me çështjet e drejtësisë tranzicionale. Të dhënat e anketës së majit të vitit 2024 kanë treguar se gjithsej 50.7% e të anketuarve kanë pohuar se trashëgimitë e konfliktit dhe e kaluara kolektive e Kosovës nuk janë mbuluar profesionalisht në media, krahasuar me 59.3% në nëntor të vitit 2023. Gjithsej 36.3% besojnë se trashëgimitë e konfliktit dhe e kaluara kolektive janë mbuluar në mënyrë profesionale në media. Të dhënat e zbërthyer etnikisht kanë treguar se një pjesë më e madhe e shqiptarëve të Kosovës (38%) besojnë se trashëgimitë e konfliktit dhe e kaluara kolektive mbulohej profesionalisht në media, krahasuar me serbët e Kosovës (20.5%) dhe komunitetet e tjera të Kosovës (23.2%).


**FIGURA 13:** OPINIONI I TË ANKETUARVE PËR MBULIMIN PROFESIONAL TË TRASHËGIMISË SË KONFLIKTIT DHE TË KALUARËS KOLEKTIVE TË KOSOVËS NË MEDIA



Gjithsej 10.9% dhe 40.9% e të anketuarve besojnë plotësisht dhe besojnë se Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë (Marrëveshja) do të ndikojë pozitivisht në jetën e qytetarëve të Kosovës, për dallim nga 16% dhe 42.9% në nëntor të vitit 2023, respektivisht. Gjithsej 33.1% e të anketuarve kanë deklaruar se besojnë se Marrëveshja do të ketë efekt pozitiv në një farë mase, krahasuar me 22.8% në nëntor të vitit 2023. Përderisa 10.2 dhe 1.7% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk do të ndikojë,

dhe nuk do të ndikojë fare, 3.1% kanë deklaruar se nuk e dinë, krahasuar me 4.4%, 5.9% dhe 8%. Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike kanë treguar se 52.9% e shqiptarëve të Kosovës dhe 51.6% e komuniteteve të tjera të Kosovës kanë pikëpamje pozitive për Marrëveshjen, krahasuar me 25.7% të serbëve të Kosovës.

**FIGURA 14:** PERCEPTIMI I TË ANKETUARVE SE A DO T'INDIHMOJË KOSOVËS MARRËVESHJA PËR RRUGËN DREJT NORMALIZIMIT TË MARRËDHËNIEVE MIDIS KOSOVËS DHE SERBISË NË RRUGËN E SAJ DREJT BE-së.



Të anketuarit janë pyetur edhe për shkallën në të cilën ata besojnë se Marrëveshja do t'i ndihmojë Kosovës në rrugën e saj drejt BE-së. Gjithsej 50.6% e të anketuarve besojnë plotësisht ose besojnë se Marrëveshja do t'i ndihmojë Kosovës në rrugën e saj drejt BE-së. Përderisa 35.8% kanë deklaruar se besojnë që Marrëveshja do t'i ndihmojë Kosovës në rrugën e saj drejt BE-së deri diku, 10.3% kanë deklaruar se nuk besojnë fare ose nuk besojnë, ndërsa 3.4% kanë deklaruar se nuk e dinë.

Të dhënat e zbërthyera etnikisht kanë treguar se shqiptarët e Kosovës (50.9%) dhe komunitetet e tjera të Kosovës (45.8%) janë më optimistë krahasuar me serbët e Kosovës (24.8%) se Marrëveshja do t'i ndihmojë Kosovës në rrugën e saj drejt BE-së.

# Metodologjia

**G**jetjet që janë paraqitur në këtë përmbledhje janë bazuar në një anketë në të cilën janë anketuar 1,306 qytetarë të Kosovës të moshës mbi 18 vjeç, nga 17 prilli deri më 7 maj të vitit 2024. Mostra ka përfshirë numër të njëjtë të burrave dhe grave nga të gjitha komunat dhe rajonet e Kosovës, duke i mbuluar si zonat urbane, ashtu edhe ato rurale. Sa i përket përfaqësimit etnik, mostra ka përfshirë 896 shqiptarë të Kosovës, 210 serbë të Kosovës dhe 200 anëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës (ashkali, boshnjakë, egjiptianë, goranë, romë dhe turq të Kosovës). Anketa është bazuar në një marrje të mostrës me probabilitet rastësor në shumë faza dhe është zhvilluar përmes intervistave sy më sy. Mostra është përfaqësuese e ekonomive familjare në Kosovë.<sup>4</sup>

## Peshimi i totaleve të popullatës

Anketat e Pulsit Publik marrin mostra më të mëdha nga pakicat, në mënyrë që të dhënat të zërthehen sipas përkatësisë etnike. Megjithatë, kur llogariten totale e shifrave, ekipi i Pulsit Publik i peshon të dhënat sipas shifrave aktuale të popullsisë. Që nga viti 2002, janë përdorur përqindjet e mëposhtme për peshimin e totalit të popullsisë:

SHQIPTARËT  
E KOSOVËS



SERBËT  
E KOSOVËS



PJESËTARËT E  
KOMUNITETEVE TË TJERA  
TË KOSOVËS



<sup>4</sup>Në këtë raport janë përdorur termat “përqindje” dhe “pikë e përqindjes”. Një pikë e përqindjes është diferenca numerike midis dy përqindjeve; ndërsa përqindja është raporti i shprehur si fraksion i 100-shit. Përqindja i referohet shkallës së ndryshimit, ndërsa pika e përqindjes e mat sasinë aktuale të ndryshimit.

## Llogaritja e indekseve

Indeksi Demokratik (ID-ja) është një mesatare e përbërë e bazuar në nivelin e pajtimit ose mospajtimit të të anketuarve me zhvillimet e mëposhtme në Kosovë: shkalla e zgjedhjeve të lira dhe të drejta, monitorimi i Kuvendit, performanca e institucioneve qendrore, pavarësia e sistemit gjyqësor, liria e shprehjes dhe mediave, ekzistenca e një shoqërie civile mbikëqyrëse, Kushtetuta dhe ligjet e bazuara në të drejtat e njeriut dhe nëse pushteti lokal dhe ai qendror punojnë sipas prioriteteve të qytetarëve. ID-ja është matje e vazhdueshme e cila shkon nga 0 në 3, ku rezultati prej 0 do të thotë që asnjë nga anketuarit nuk konsideron që demokratizimi është në rrugën e duhur, ndërkaq rezultati nga 1.5 në 3 do të thotë se shumica e të anketuarve pajtohen se demokratizimi është në rrugën e duhur.

Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike (IBE) është një mesatare e përbërë e cila llogaritet në bazë të vlerësimit të të anketuarve për kushte të favorshme ose të pafavorshme ekonomike në Kosovë. Konkretisht, të anketuarit i vlerësojnë kushtet në vijim: pritshmëritë lidhur me të hyrat totale të familjeve të tyre, kushtet e punësimit për gjashtë muajt e ardhshëm, dhe vlerësimin e kushteve aktuale të biznesit dhe punësimit. IBE-ja është një matje e vazhdueshme me vlera që shkojnë nga 0 në 3, ku harku prej 0 deri në 1.5 tregon një vlerësim të pafavorshëm të gjendjes ekonomike nga shumica e popullatës, kurse harku prej 1.5 deri në 3 tregon një vlerësim të favorshëm nga shumica.



